

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

28 Prill, 2020

Të dashur studentë dhe familje të klasave të 12^{ta},

Shpresoj kjo letër t'ju gjejë ju dhe familjen tuaj mirë gjatë kësaj kohe.

Më 9 Prill, ne ndamë një lajm jo të mirë se ndërtesat e shkollave tona do të mbeten të mbyllura për pjesën tjetër të vitit shkollor dhe se ngjarjet shoqërore të sponsorizuara nga shkolla që ju prisni gjatë gjithë vitit, siç janë "proms" dhe diplomimi do të anulohen për shkak të pandemisë COVID-19. Ndërsa këto zgjidhje u bënë duke u bazuar në sigurinë dhe shëndetin e studentëve tanë në mendje,. Edhe pse këto ngjarje nuk mund të ecin përpara në një mënyrë tradicionale, ne mbetemi plotësisht të përkushtuar për të festuar me siguri Klasën e vitit 2020 duke filluar nga fundi i Majit. Ju e meritoni atë dhe shumë më tepër. Unë po shkruaj sot për të ndarë disa nga planet tona me ju.

Festimet e Klasave të vitit 2020

Një ekip planifikues ka qenë duke punuar së bashku me anëtarët e Këshillit tim Konsultiv Studentor për të krijuar disa përvoja emocionuese dhe të paharrueshme për Klasën e vitit 2020, duke përfshirë:

- një diplomim virtual në gjithë Drejtorinë me shfaqje speciale, një surprizë (tani për tani) një folës i famshëm dhe i veçantë, ftesë e mundshme për të gjithë për t'ju ndihmuar të përfshini familjen dhe miqtë në përvojën tuaj të diplomimit,
- një "after-party" virtual festim për diplomim të organizuar nga një DJ i njohur,
- një fushatë reklamimi në të gjithë vendin me reklama të personalizuar për çdo shkollë të mesme të Drejtorisë,
- një fushatë e medias e drejtuar nga studentët ku ju mund të prezantoni shkollën tuaj, dhe
- një mundësi që çdo banor i Filadelfias në të gjithë qytetin të angazhohet në një aktivitet të njëkohshëm për të nderuar Klasën e vitit 2020.

Përveç këtyre planeve, shkollat e mesme nga ana e tyre mund të zgjedhin të bëjnë diplomimin ose festën e tyre virtuale për studentët e tyre në Qershor. Personeli i shkollës do të sigurojë më shumë informacione nëse ata ndjekin këtë mundësi. Me sigurinë si përparësinë tonë kryesore, asnjë ngjarje me pjesëmarrje reale të studentëve nuk do të planifikohet nga Drejtoria ose shkolla juaj deri në njoftimin e mëtejshëm.

Pas Qershorit 2020

Ne e kuptojmë se asnjë program virtual nuk mund të zëvendësojë ecjen reale përgjatë ceremonisë së diplomimit me kapelen dhe veshjen tuaj, me shokët e klasës dhe duke hedhur kapelen tuaj në ajër për të kurorëzuar vitet tuaja të punës së palodhur. Ne do të punojmë me shkollat tona të mesme për të provuar dhe siguruar një përvojë më tradicionale për ju pasi të hiqen zyrtarisht urdhërat për qëndrimin në shtëpi dhe për distancimin shoqëror. Ju lutemi e dini që ka të ngjarë të kalojë ca kohë para se të ndodhë kjo.

Një azhurnim mbi tarifën e paguar


Drejtoria vazhdon të punojë me shkollat e mesme për të përcaktuar procesin e rimbursimeve. Rimbursimet do të ndryshojnë sipas shkollës bazuar në paketën e detyrimeve të secilës shkollë dhe statusin e planifikimit. Për shembull, në rastet kur janë porositur mallra siç janë librat vjetorë dhe bluzat e maturantëve(seniors), prapëseprapë mund të prisni që t'i merrni ato mallra kur dhe si është e sigurt t'i keni ato. Sidoqoftë, në rastet kur janë bërë pagesa paraprake për vendet, do të na duhet kohë për të përcaktuar se si dhe nëse shkollat do të rimbursohen nga këto vende. Ne kërkojmë durimin tuaj të vazhdueshëm ndërsa punojmë përmes ndërlikimeve të kësaj situate në javët në vazhdim. Gjithashtu, nëse ende nuk keni paguar tarifa, shkollat individuale ende mund t'ju lejojnë t'i paguani ato në mënyrë që të merrni disa nga artikujt e përfshirë në paketat e tyre. Shkolla juaj do të sigurojë më shumë informacion gjatë javëve të ardhshme.

Ndërsa po e mbyllim këtë vit shkollor, ju gjithashtu mund të prisni më shumë informacione rreth mundësive për të rihyrë në mënyrë të sigurtë në shkollat tona për të tërhequr çdo send personal që mund të keni lënë në dollapët tuaj dhe të dorëzoni çdo pajisje, tekste shkollore dhe uniforma sportive.

Pavarësisht nga rrethanat, asgjë dhe askush nuk mund të heqë vitet e punës suaj të palodhur, zell dhe këmbëngulje për t'u bërë një i diplomuar krenar i Drejtorisë Arsimore të Filadelfias Class of 2020. URIME! Jam në pritje të festoj me ju në javët e ardhshme dhe t'ju azhurnoj ndërsa përparojnë planet tona.

Ndërkohë, ju lutemi të kujdeseni dhe të qëndroni të sigurt.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Mbikëqyrës

Qarku Shkollor i Filadelfisë